



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPSTINA VUCITRN	
01 Nr. / Br	148/19
Nr. i fq. / Br. st	-9-
Data: / Datum	16.05.2019
VUCITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e -IV-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
11 prill 2019 në sallën e komunës, e cila filloi në ora 10:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli-Latifi, Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i komunës), Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Afrim Namani, Saranda Cakaj, Berat Sadiku, Adnan Lahu, Berat Asllani dhe Refik Maloku), Adlije Trepça, zyrtare në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Rabije Zahiti, zyrtare në Drejtorinë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe nga sekretaria, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ai deklaroi se disa pika kanë ardhur për t'u proceduar edhe në të ndryshme, i cili kërkoi që të futen në rend të ditës.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës <Propozim-vendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale> që është dërguar për t'u futur në rend të ditës. Arsyeja është se ekziston një vendim i mëhershëm dhe në bazë të atij vendimi i kemi ndjek të gjitha procedurat, tha ai.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se në mbledhjen e kaluar ka bërë një pyetje lidhur me disa projekte që janë të publikuara në webfaqe. Mbrëmë shikova në webfaqe dhe nuk kishte asnjë përmirësim. Ai po ashtu theksoi se aktualisht nuk jemi duke u monitoruar nga MAPL-ja, për shkak se në mbledhjet e kuvendit mungon teleprezenca. Po ashtu kërkoi përgjigje se pse nuk po bëhet monitorimi i mbledhjeve të kuvendit të komunës, si dhe tha se disa komuna janë duke e bërë incizimin e mbledhjeve të kuvendit me kamera dhe incizimet e tyre i gjen në webfaqet e komunave.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - lidhur me projektet që janë të publikuara në webfaqe, Muzaqi theksoi se ashtu siç e kemi menduar, ashtu edhe ka dalë, sepse bëhet fjalë për një gabim teknik. E kam sjellë me vete të përmirësuar këtë, kurse në webfaqe nuk është përmirësuar për shkak se zyrtari i IT-së gjendet në pushim.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – lidhur me monitorimin, Aliu theksoi se nuk kemi marrë vërejtje asnjëherë, pasi që, incizimi iu dërgohet çdoherë edhe MAPL-së. Sa i përket teleprezencës, ai tha se do të angazhohemi për këtë dhe ta shohim se ku qëndron problemi.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se ne jemi trup i kuvendit dhe se punët e kuvendit nga punët e qeverisjes komunale duhet të ndahen.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – propozoi që të futen në rend të ditës dy propozime:

- Shqyrtimi i mundësive për renovimin e “Urës së Pestovës”;
- Shqyrtimi i mundësive për përkrahjen financiare të studentes, Ujeza Ademi.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – kërkoi që pika e gjashtë e rendit të ditës < Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e rrugëve> të hiqet nga rendi i ditës, pasi që sapo na erdhi lista e rrugëve dhe nuk kemi mundësi ta dimë tani për tani se cilat kanë qenë kërkesat e qytetarëve që i kanë paraqitur në dëgjimet buxhetore, pasi siç tha ai po e shoh që ka devijime të mëdha..

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se është hera e parë që drejtoria formon komision për vlerësim të rrugëve në terren. Ai tha se komisioni ka dalë në terren dhe ka bërë vlerësimin e rrugëve, ku ka hartuar një listë të rrugëve me prioritet. Po ashtu tha se nuk kemi qenë të obliguar ta sjellim në KPF, si dhe të fillojmë menjëherë me procedurat, por kemi dashur që të jemi transparent.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - deklaroi se nuk është obligative që ta votojë KPF-ja. Kemi dhënë një zotim që ta sjellim këtë listë në KPF për t’iu informuar. Ai tha se për këtë vit, kërkesat për asfaltim të rrugëve janë në vlerë prej 4 milionë euro, kurse mundësitë buxhetore janë 400.000 euro. Nëse shtyhet procesi i tenderimit, atëherë mund të shkojnë mjetet në suficit. Nëse dikush dyshon që ka hy në listë ndonjë rrugë që nuk ka qenë kërkesë e qytetarëve, këtë mund ta vërtetoni nga procesverbalet e dëgjimeve buxhetore, por, nuk ka kuptim të shtyhet procesi.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se kjo pikë e rendit të ditës është mirë që të diskutohet dhe të dërgohet në kuvend, sepse konsideroj që ka kohë të mjaftueshme pastaj të analizohet.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - deklaroi se në mbledhjen e KPF-së kur është diskutuar për buxhetin, jemi dakorduar që të vjen lista e rrugëve në KPF dhe ky ka qenë zotim i qeverisjes. Kjo listë e rrugëve ka ardhur me vonesë për ju si anëtarë të KPF-së, por ju jeni ata që vendosni se çka të veprohet.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se në mbledhjen e KPF-së që është diskutuar buxheti, e kemi pasur një listë të rrugëve. Në fshatin Pantinë, kanë qenë disa rrugë me prioritet, e në mesin e tyre ka qenë edhe rruga “Arif Arifi”. Le që është hequr nga lista, por edhe kanë përhapur fjalë që Neziri iu kanë thënë për atë rrugë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – pyeti se si ka mundësi që kuvendi merr vendim të enjten për asfaltimin e rrugës “Indrit Cara”, kurse të hënën fillojnë menjëherë punimet në rrugë? Kur u shpall aq shpejt tenderi? Prandaj, brenda tri dite të zhvillohen procedurat, kur nuk ka qenë e planifikuar fare në buxhet.

Refik Maloku, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – tha se ato ditë kur jam emëruar drejtor, kuvendi ka marrë vendim për këtë rrugë, prandaj, theksoi se nuk është në dijeni për këtë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - theksoi se asfaltimi i rrugës “Indrit Cara” do të bëhet nga fondi për <bashkëfinancim me donatorë>.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se a është rrugë publike?

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - deklaroi se detajet nuk i di, por nëse nuk është rrugë publike, atëherë do të merr përgjegjësi secili zyrtar, apo drejtor kushdo qoftë që është përgjegjës.

Komiteti për Politikë dhe Financa me pesë (5) vota “për”, tri (3) “kundër”, votoi që të mos futet në rend të ditës < Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e rrugëve>.

Komiteti për Politikë dhe Financa me tri (3) vota “për”, tri (3) “kundër”, dy (2) “abstenime”, votoi që të futet në rend të ditës <Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” sh.a.>, pasi që kryesuesi në vota të barabarta vendosi për futje në rend të ditës.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri votoi që të mos futet në rend të ditës <Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale>.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - lidhur me Urën e Pestovës që është në ndërtim, theksoi se ky është projekt i Ministrisë për Infrastrukturë. Ai tha se iu ka dërguar shkresë zyrtare: sekretarit të ministrisë, këshilltarit politik të ministrit, shefit të kabinetit të ministrit, si dhe menaxherit të projekteve të komunës sonë lidhur me këtë çështje. Sipas informacioneve, përfaqësues të Ministrisë për Infrastrukturë e kanë vizituar uUën në Pestovë dhe janë zotuar se do të vazhdojnë punimet. Sipas Tahirit, Ura e Pestovës (që është në ndërtim) është projektuar keq, pasi që planifikimi është bërë në pronë private. Po ashtu, ai theksoi se duhet të shpronësohen 60m² për të filluar funksionalizimi. Nga ana e komunës, të gjitha procedurat e shpronësimit janë kryer, ndërkaq, lidhur me urën e vjetër ekzistuese, Tahiri tha se nuk ka kuptim që komuna të investojë 5000 apo 6000 euro, pasi që ura e re është gati në përfundim.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për” votoi që të futet në rend të ditës <Shqyrtimi i mundësive për renovimin e “Urës së Pestovës”>.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri votoi që të futet në rend të ditës <Shqyrtimi i mundësive për përkrahjen financiare të studentes, Ujeza Ademi>.

Komiteti për Politikë dhe Financa me kërkesë të kryetarit të komunës njëzëri votoi që <Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” sh.a.> të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” sh.a.;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 mars 2019;
3. Shqyrtimi i Raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
4. Shqyrtimi i informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë;

5. Shqyrtimi i informatës tremujore për sigurinë ushqimore;
6. Shqyrtimi i informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore;
7. Shqyrtimi i petitionit për kthimin e emrit të rrugës “Bajram Bozhilani”;
8. Shqyrtimi i mundësive për renovimin e “Urës së Pestovës”;
9. Shqyrtimi i mundësive për përkrahjen financiare të studentes, Ujeza Ademi;
10. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” sh.a.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - deklaroi se duke i marrë parasysh nevojat për shërbime më të mira të qytetarëve dhe duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 11 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe në Statutin e Komunës i kemi propozuar KPF-së dhe Kuvendit të Komunës themelimin e ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” sh.a. Prandaj, përpara e keni propozim-vendimin, në të cilin janë paraqitur edhe kompetencat e ndërmarrjes së re, e cila do të themelohej.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – pyeti se kush i rregullon ashensorët?

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se kjo është çështje e menaxhimit të kompanisë dhe se nuk ndërhyjmë në çështjet e brendshme të kompanisë. Ideja është që kompania t’i ketë tre apo katër teknike që i mirëmbajnë ashensorët dhe gjenerojnë të hyra. Ai theksoi se ky është vetëm hapi apo vendimi fillestar, pastaj më vonë me plan të biznesit specifikohen detajet (numri i punëtorëve, qëndrueshmëria financiare etj) dhe i dërgohet Komitetit Ndërmarrës për themelimin e ndërmarrjeve komunale dhe atje merret aprovimi. Pasi që të merret aprovimi, kthehet në kuvend të komunës, ku zgjedhen aksionarët. Aksionarët e zgjedhin bordin drejtues, pastaj bordi e zgjedh drejtorin dhe fillon të funksionojë kompania.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – deklaroi se duke e parë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e ndërmarrjes publike komunale për qytetin tonë, do t’i japim përkrahje të plotë këtij propozim-vendimi.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - theksoi se i ka munguar qytetit tonë një ndërmarrje publike komunale, prandaj edhe duhet ta përkrahim në mënyrë që ta bëjmë funksionale.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se kjo do të ishte një e mirë për qytetin tonë nëse do të ndodh. Por, po frikësohem që gjatë rrugëtimit të këtij procesi mund të kemi probleme.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja votoi njëzëri që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 mars 2019.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi që të përmirësohet në faqen 5 dhe formulimi të mbetet kështu < P.sh. te palestra e sportit, kulmi nuk ka izolim, kurse konsumi specifik del të jetë 14 kwh/ m² në vit, që i bie se ky objekt është super i izoluar >.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri me ndryshime aprovoi procesverbalin e datës 14 mars 2019.

3. Shqyrtimi i raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – sqaroi se është bërë një gabim teknik në faqen e parë tek Drejtoria për Inspektime. Për kuvend do të vjen e përmirësuar.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – kërkoi nga sekretaria e kuvendit që ta sjellin vendimin e kuvendit të komunës për asfaltimin e rrugës “Indrit Cara” dhe ta dimë se prej cilit kod buxhetor do të bëhet pagesa. Ai theksoi se vendimet hyjnë në fuqi 7 ditë pasi që të jep vlerësim MAPL-ja. Pra, edhe këtu kemi shkelje ligjore, theksoi Zhegrova.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – në informatë është cekur se ka objekte afariste pa leje. Ai kërkoi që ta dimë se cilat objekte afariste janë ndërtuar pa leje (nëse nuk është konfidenciale)? A iu kanë ndërprerë punimet?

Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – theksoi se fjala është për objekte të vogla afariste, ku ne si drejtori kemi marrë masa ligjore dhe është kërkuar prej tyre që të pajisen me leje.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i informatës tremujore për sigurinë ushqimore.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – kërkoi që të plotësohet kjo informatë, t’i bashkëngjitet lista e shfrytëzuesve me qira të pronës komunale. Po ashtu, ajo pyeti edhe a ka shfrytëzues të pronave komunale, por që nuk paguajnë qira?

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – theksoi se me vendim të kryetarit, menaxhimi i kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale ka kaluar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë. Ai deklaroi se më herët nuk ka ekzistuar një listë e pronave komunale, kurse tani ekziston kjo listë. Po ashtu theksoi se ka prona të uzurpuara, i cili shtoi se kemi filluar ta përgatisim një listë të këtyre pronave.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se në sistem kanë qenë të evidentuara të gjitha pronat komunale dhe se nuk qëndron ajo që tha drejtori se ka ekzistuar listë e pronave komunale. Klinaku deklaroi se unë si ish-drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që kam qenë së bashku me Nasuf Aliun, si ish-drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural jemi ndër të parët në Kosovë që kemi arritur t’i japim në shfrytëzim pronat komunale.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – deklaroi se listimi i pronave komunale ka ekzistuar edhe në të kaluarën.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se nuk ka ekzistuar një listë e pronave komunale nëse dikush e ka kërkuar (p.sh auditorët).

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se lista e pronave komunale ka ekzistuar, por lista e shfrytëzuesve të pronave komunale nuk i është prezantuar kuvendit komunal.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – deklaroi se lista e shfrytëzuesve të pronave komunale ka qenë në kuvend, dhe se ajo që e tha drejtori nuk qëndron.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që me plotësime të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i peticionit për kthimin e emrit të rrugës “Bajram Bozhilani”.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – tha se këtë peticion pala e ka dërguar edhe më herët, por e kam kthyer në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Mirëpo, pala e ka konsideruar se i është bërë e padrejtë, dhe iu ka drejtuar kuvendit me këtë peticion.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se ka shumë ankesa sa u përket rrugëve që me vite nuk janë shqyrtuar. Na është drejtuar si peticion dhe jemi të obliguar si kuvend që ta shqyrtojmë këtë dhe t’ia kthejmë një përgjigje në afat prej 30 ditësh. Zhegrova propozoi themelimin e një komisioni për këto raste.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se propozimi i Shpëtimit është i arsyeshëm. Ai tha se në fillim, kur është bërë emërtimi i rrugëve, kjo rrugë në fshatin Sllatinë e kishte emrin “Bajram Bozhilani” (komplet rruga). Në vitin 2015, ishte një kërkesë në drejtori për ndarjen e këtij segmenti të rrugës nga vëllezërit “Ferati”, 4 – 5 shtëpi, kurse pjesa tjetër e rrugës të mbetet “Bajram Bozhilani”, kurse konsideroj që komisioni ka vepruar drejt që e ka ndarë këtë segment.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me një rast, por ka raste edhe tjera. Prandaj, çka do që të bëhet me këtë rrugë, a do t’iu jepet rasti edhe kërkesave të shumta që janë për ndryshim të rrugëve.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – meqenëse vijnë vazhdimisht kërkesa, atëherë atë që e tha Shpëtimi është në rregull që të krijohet një komision afatgjatë për trajtimin e të gjitha kërkesave.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se ky problem në mes të këtyre familjeve ka qenë edhe në televizion. Problemin ata e kanë se kush ia ka hequr emrin rrugës “Bajram Bozhllani”. Unë kisha propozuar që Ali Januzi të jetë anëtar i komisionit, sepse konsideroj që mund të jep kontribut në këtë drejtim.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – tha se nuk pajtohet për themelimin e komisionit për shkak se anëtarët janë nga subjektet politike dhe dikush mund t’iu thotë atyre se unë desha me ta rregulluar problemin, por ky tjetri nuk do.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se nuk është mirë të kemi paragjykitime për punën e komisionit. Edhe unë e përkrahu që Ali Januzi të jetë në komision për shkak të përvojës së tij.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës dhe kuvendi ta themelojë një komision.

8. Shqyrtimi i mundësive për renovimin e “Urës së Pestovës”.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – theksoi se një pjesë e madhe e banorëve të fshatrave të Artakollit kalojnë nëpër Urën e Pestovës (ura e vjetër), e cila ka filluar të dëmtohet. Prandaj, do të ishte mirë që të intervenohet sado pak për ta rregulluar urën e vjetër, sepse ura e re mund të vonohet derisa të rregullohet, kurse Ministria e Infrastrukturës ka dy vite që është duke punuar në ndërtimin e urës së re.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se Drejtoria për Shërbime Publike mundet me procedurë të përshpejtuar me tri oferta deri në 1000€.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se jemi të shqetësuar me situatën e sigurisë tek Ura e Pestovës. Pak kemi mbetur peng i premtimeve të ministrisë, të cilët na kanë thënë se shumë shpejtë do të rregullohet ura e re. Prandaj, për shkak të këtyre premtimeve kemi hezituar që të investojmë në diçka që shumë shpejt ai material do të zhvendoset, kurse konstruksioni është i paraparë që të vendoset në Urën e Dobërlukës. Ai tha se siguria e qytetarëve është shumë më e rëndësishme se kursimet financiare dhe ne si qeverisje do ta analizojmë këtë.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – tha se deri në kuvend, Drejtoria për Shërbime Publike ta analizojë këtë çështje.

9. Shqyrtimi i mundësive për përkrahjen financiare të studentes, Ujeza Ademi.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – qyteti i Vushtrrisë duhet të krenohet me një studente, siç është Ujeza Ademi, e cila vitin e kaluar është pranuar në Akademinë e Animacionit në Malajzi. Por, në mungesë të mjeteve financiare për akomodim, ajo nuk ka mundur të marrë pjesë. Tash së fundi, ajo është pranuar përsëri në Akademinë e Animacionit në Francë. Ajo propozoi që t’i ndahen mjete financiare për t’i mbuluar shpenzimet për akomodim.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – tha se si Ujeza kemi shumë studentë nga Komuna e Vushtrrisë që po tregojnë suksese ndërkombëtare. Ajo u shpreh se e përkrah jo vetëm Ujezën, por të gjithë të tjerët, si dhe kërkoi që Ujeza ta sjell kërkesën së bashku me

informacione të detajuara nga universiteti që është pranuar. Tutje tha se është mirë që viteve tjera të rritet buxheti për këtë kategori, në mënyrë që të përkrahen studentë të tillë.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se është mirë të bëhet e njëjta rregull, sepse sa herë që vijnë kërkesa të kësaj natyre të jetë e njëjta rrugë. Pra, të krijohet një standard, tha ai.

Refik Maloku, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – deklaroi se duhet të vendosen standarde për të gjithë, e jo një rast të merret parasysh e raste tjera të anashkalohen.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që me plotësim të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës.

10. Të ndryshme.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se asfaltimi i rrugës “Indrit Cara” në bazë të vendimit të kuvendit nuk ka qenë nga fondi për bashkëfinancim, por ka qenë nga kodi për rikonstruim të rrugëve nga Drejtoria për Shërbime Publike. Ajo rrugë nuk është për rikonstruim, sepse është rrugë e pashtuar, tha Zhegrova. Prandaj, forma e procedurës në të cilën është vepruar është e paligjshme.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - theksoi se kjo kërkesë erdhi në kohën kur u emërua drejtori i ri dhe se as unë nuk kam qenë i njoftuar me procedurat.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se jam ndjerë keq për shkak të emrit të dëshmorit “Indrit Cara”, por kam votuar “kundër” për shkak të asfaltimit të rrugës, për të cilën kisha dilema sa i përket formës së rrugës. Përderisa u votua që të asfaltohet kjo rrugë, atëherë të asfaltohet në tërësi, e jo si pjesë e saj (segment).

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se në mbledhjen e kaluar kam kërkuar informatë me shkrim për dy çështje, për të cilat nuk kam marrë përgjigje:

- Sa është numri i vendeve të lira në administratën komunale të Vushtrrisë?
- Lidhur me projektin <Asfaltimi i rrugës Stanoc-Lumadh-Prelluzhë-Gracë (projekt dyvjeçar)>?

Ai kërkoi përsëri përgjigje me shkrim për këto dy çështje. Po ashtu, ai ripërsëriti kërkesën e tij për vendosjen e pengesave në rrugë tek shkollat (e mesme dhe profesionale), ku tha se kishte me qenë mirë që Drejtoria për Shërbime Publike t’i vendos disa pengesa për shkak të sigurisë së nxënësve, si dhe pyeti se deri ku ka shkuar procedura për këtë çështje?

Refik Maloku, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – theksoi se pajtohet për vendosjen e pengesave në rrugë tek shkollat. Vetëm duhet ta shikojmë se si është procedura dhe se a kemi mjete financiare të planifikuar për këtë çështje.

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim – theksoi se disa herë është biseduar për këtë çështje, madje edhe kërkesa janë bërë. Po ashtu, është biseduar edhe me policinë lidhur me vendosjen e pengesave tek shkollat. Kam informata që është nënshkruar kontrata, por vetëm ka mbetur që të bëhet ekzekutimi, tha Namani. Është punë që kryhet nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - theksoi se Drejtoria për Shërbime Publike ta analizojë këtë çështje dhe të veprojë në harmoni me procedurat ligjore.

Mbledhja përfundoi në orën **12:25**.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës

Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim – theksoi se disa herë është biseduar për këtë çështje, madje edhe kërkesa janë bërë. Po ashtu, është biseduar edhe me policinë lidhur me vendosjen e pengesave tek shkollat. Kam informata që është nënshkruar kontrata, por vetëm ka mbetur që të bëhet ekzekutimi, tha Namani. Është punë që kryhet nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - theksoi se Drejtoria për Shërbime Publike ta analizojë këtë çështje dhe të veprojë në harmoni me procedurat ligjore.

Mbledhja përfundoi në orën **12:25**.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Nasuf Aliu
Kryesues i KK-së dhe i KPF-së